



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 pika 11) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.11.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 3058/13, për z. Naim Haliti - Dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për Zyrtarin e Lartë z. Naim Haliti – Dekan në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Haliti është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 14.10.2013), pas së cilës zyrtari i lartë ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të parandaluar gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë është ftuar në Agjenci në takim dhe është këshilluar konform ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për situatën në të cilën ndodhet, si dhe situatat që mund të paraqiten gjatë ushtrimit të funksionit publik dhe që mund ta sjellin zyrtarin e lartë në situatë të gjendjes së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Haliti ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë(DPKI.03- 3501/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në biznesin Zyrë Shërbyese “Eksperti Naimi” për të ushtruar funksionin e tij publik si Dekan në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, me çka ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

